



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 205 Prot.

Tiranë, më datë 24.04.2026

VENDIM
Nr. 148 datë 24.04.2026

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 24.04.2026:

VENDOSI

- Miratimin e projektit “Ndërtim pedonale pranë urës së Bratit, fshati Brataj, Bashkia Selenicë”, Vlorë, Brenda Kufirit të Zonës Mbrojtëse të Monumentit, me aplikues Z. Ergys Çausi dhe zhvillues **Bashkia Selenicë, me rekomandimet:**
 - Detaji i pikës fundore të pedonale të rishikohet gjatë zbatimit të punimeve me qëllim të mos çënohet struktura e Monumentit të Kulturës së Kategorisë së I-rë me emërtimin “Ura e Bratajt në fshatin Brataj”;
 - Gjatë zbatimit të punimeve për ndërtimin e pedonale të parashikohet rehabilitimi i plotë i zonës dhe të zgjidhet vegetacioni në përputhje me peizazhin natyror;
 - Gjatë zbatimit të punimeve të monitorohet në vazhdimësi struktura e monumentit të kulturës që të mos shkaktohen çarje strukturore nga procese të caktuara që lidhen me ndërtimin e pedonale;
- Gjatë procesit të zbatimit punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 72, pika 1 dhe 2;
- Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
- Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi;
- Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Endri HAXHIU

KRYETAR
Blendi GONXHJA

